

Përmbledhja e veprës “Gërsheti”

Tri gra, tri jetë, tri kontinente. E njëjta etje për liri. Një gërshet i padukshëm i bashkon.

Indi. Smita është një e Paprekshme, që do të thotë kasta më e fundit dhe më e nëpërkëmbur në Indi, Dalitët. Si e tillë, ajo jo vetëm nuk ka të drejta, por është e dënuar të bëjë një punë poshtëruese, të cilën e ka bërë gjyshja dhe e ëma e saj: të mbledhin jashtëqitjet e fshatit. Dëshira e saj e vetme është të shohë vajzën e saj të shpëtojë nga kjo gjendje mjerane, e paracaktuar dhe për të, dhe të shkojë në shkollë. Ajo, bashkë me vajzën, vendos të largohet nga fshati ku ka lindur, edhe pse ky largim vë në rrezik jetën e të dyjave.

Sicili. Xhulia është njëzet vjeçe dhe punon në punishten e të atit, në Palermo. Familja e saj prej disa brezash është marrë me trajtimin e flokëve të mbledhur nëpër parukeri dhe shndërrimin e tyre në parukë, një punë e bukur dhe fisnike, e bërë me përkushtim dhe pasion. Është një artizanat që po zhduket dalëngadalë, dhe punishtja e të atit është e vetmja që i ka rezistuar kohëve në qytetin e tyre. E gjithë familja e saj jeton falë këtij aktiviteti, për të cilin është aq krenar babai i saj, Pietro. Kur ai pëson një aksident dhe bie në koma, Xhulia merr drejtimin e punishtes, por ndërkohë do të njohë dhe dashurinë. Një ditë ajo zbulon që ndërmarrja e familjes së saj ka falimentuar dhe bota e saj shembet.

Kanada. Sara jeton në Montreal, ajo është dyzet vjeçe dhe ka gjithçka për t’u konsideruar si femrat e kopertinave të revistave: është e bukur, joshëse, avokate e shquar, ka tre fëmijë të mrekullueshëm dhe një shtëpi në një lagje të pasur. Sara mendon se ka gjetur vendin e saj në botë, edhe pse ka sakrifikuar dy martesë, momentet me fëmijët, fundjavat e mbrëmjet në punë. Sara bën përpara me sigurinë që i jep besimi në aftësitë e veta, e konsideron veten të pathyeshme, por një sëmundje e rëndë do t’i ndërpresë planet e saj. Gjatë kësaj kohe, bota e saj shembet. Kjo përvojë do ta shndërrojë Sarën dhe do ta bëjë të heqë maskën e supergruas që e ka mbajtur gjithë jetën në fytyrë.

Të lidhura, pa e ditur përmes asaj që kanë më intime dhe më të veçantë, Smita, Xhulia dhe Sara nuk e pranojnë fatin që u është paracaktuar dhe vendosin të luftojnë. Historitë e tyre thurin një gërshet shprese dhe solidariteti.

Kopertina ballore e librit do të ketë përmasat: 14 x 20 cm

Të përmbajë në të:

Gërsheti (titulli)

Laetitia Colombani (Emri i autores)

dhe

Logo e kolanës “Rrugëtimi drejt identitetit” (ende për t’u përcaktuar)	Logo Botimet Toena
--	--------------------

Shtëpia Botuese Toena do të ngrëjë një grup pune i cili do të vlerësojë punimin më të bukur, që do të jetë edhe kopertinë e romanit në gjuhën shqipe.

Për fituesin do të ketë një vlerësim monetar.

Koha e dorëzimit të punimeve: 4 Maj 2020.

Punimet tuaja dërgojini në adresën email: project.coordinator.toena@gmail.com në formatin pdf.

Shënoni qartë në emailin tuaj: emrin, mbiemrin dhe numrin e telefonit.